

SYLLABUS I LËNDËS: Menaxhment i burimeve njerëzore

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Menaxhment i burimeve njerëzore
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti II, Semestri IV
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Përcaktohet nga Dekanati
Mësimdhënësi:	Prof. Dr. Enver Kutllovci Prof. Ass. Dr. Liridon Veliu
Detajet kontaktuese:	enver.kutllovci@uni-pr.edu liridon.veliu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Lënda “Menaxhment i burimeve njerëzore” synon të prezantoj tek studentët se si organizatat menaxhojnë burimet njerëzore në përgjithësi. Kjo lëndë shqyrton rolin kryesor të zhvillimit të burimeve njerëzore në organizatë për të ndihmuar njerëzit dhe organizatat në mënyrë efektive për të menaxhuar ndryshimin.</p> <p>Lënda përfshin të gjitha elementet që ndikojnë në përvetësimin e njohurive në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore duke e përfshirë arritjen e aftësive dhe njohurive përkitazi me burimet njerëzore. Problemet e trajtuara në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore të natyrës dhe zhvillimit të saj, organizimit të punës, planifikimit të nevojave të tyre, rekrutimit, seleksionimit, formimit të punonjësve, vlerësimit të performances dhe shpërblimit, shëndetit dhe sigurisë në punë të burimeve njerëzore në kompani. Lëndë është interaktiv dhe fokusohet në strategjitë për vlerësimin, hartimin dhe zbatimin e trajnimit dhe përpjekjet për zhvillim organizativ që pozitivisht ndikojnë performancën e individit dhe grupit të punës.</p>
Qëllimet e lëndës	
	<p>Qëllimi i këtij kursi është të pajisë studentët me informacion të duhur në lidhje me konceptet kyçe të zhvillimit të burimeve njerëzore, si në aspektin teorik dhe praktik në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, duke përfshirë të gjitha elementet, që ndikojnë në fitimin e njohurive përkitazi me burimet njerëzore, planifikimin, organizimin, rekrutimin, seleksionimin, vlerësimin e performancës, shëndetit dhe sigurisë si dhe marrëdhënieve të tyre kolektive i cili zhvillohet në bazë të programeve dhe standardëve evropiane. Studentët krijojnë një perspektivë personale mbi rolin dhe rëndësinë e zhvillimit të burimeve njerëzore për të siguruar mbijetesën e organizatave të biznesit në botën moderne të globalizimit dhe zhvillimin e planeve teknike dhe teknologjike.</p>

<p>Rezultatet e pritura të nxënies</p>	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Të kuptoj dhe shpjegoj elementet themelore të Manaxhimit të Burimeve Njerëzore ✓ Të prezantoj aspekte të ndryshme teorike dhe praktike mbi Menaxhimin e burimeve njerëzore ✓ Të ndërtoj një perspektivë personale mbi rëndësinë e zhvillimit të burimeve njerëzore për të siguruar mbijetesën e organizatave të biznesit modern ✓ Të hartoj, komentoj dhe analizoj, planin e kompensimit, planifikimin dhe seleksionimin në një ndërmarrje ✓ Studentët do të pajisen me njohuri përkatëse në lidhje me funksionimin e sistemit të zhvillimit të burimeve njerëzore, jo vetëm në botën e zhvilluar, por edhe në mjedisin tonë ✓ Të fitoj njohuri për të drejtat e punonjësit, si dhe ligjet e punës të aplikuara 		
Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	13	26
Ushtrime	1	15	15
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokviume	2	2	4
Koha e studimit vetanak të studentit	2	14	28
Përgaditja përfundimtare për provim	4	5	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	4	8
Projekte, prezantime	1	9	9
Totali			125
<p>Metodologjia e mësimdhënies</p>	<p>Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjërates, detyrave praktike, interpretimeve individuale e grupore, punimit të seminareve, vetëvlerësimeve periodike.</p> <p>Metoda e punës gjatë orëve ligjërata do të përqendrohet në ligjërata dhe diskutime interaktive me pjesëmarrje të studentëve në procesin e mësimin, me prezantime individuale e grupore, të punimeve të ndryshme të përgatitura nga studentët.</p> <p>Studentët inkurajohen që paraprakisht të hulumtojnë dhe lexojnë materiale rreth temave vijuese, në mënyrë që të jenë më të përgatitur në orë të mësimin për të zhvilluar diskutime interaktive në mes të tyre me qëllim të përvetësimit më të shpejtë dhe më të thellë të çështjeve të rëndësishme të lëndës.</p>		
<p>Metodat e vlerësimit</p>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe aftësive të fituara bëhet përmes:</p> <p>a) vijueshmërisë në ligjërata dhe ushtrime: 10 pikë</p> <p>b) aktivitetit dhe punimi seminarik: 10 pikë</p> <p>c) testi i parë: 40 pikë</p> <p>d) testi i dytë: 40 pikë</p> <p>Gjithsej: 100 pikë</p> <p>Vlerësimi i provimit përfundimtar, që vlerësohet me 51% të</p>		

	suksesit, me një sistem të ndërtimit të mëtejshëm të notës përfundimtare me kriteret tjera të lartë theksuara.
Literatura	
Literatura bazë:	- Enver KUTLLOVCI, “ Menaxhimi i resurseve humane ”, Prishtinë, 2016 - Ymer HAVOLLI, “Menaxhmenti i burimeve njerëzore”, Botimi i katërt, Riinvest, 2014
Literatura shtesë:	- Talya BAUER, Berrin ERDOGAN, David CAUGHLIN, Donald TRUXILLO, “Human Resource Management: People, Data, and Analytics”, SAGE Publication, 2020 - Paul BANFIELD & Rebeca KAY, “Hyrje në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore”, 2013, UET Pres - Zana KOLI & Shyqyri LLACI, “ Menaxhimi i Burimeve Njerëzore”, 2001, Tiranë - Ilirijan LIPI, “Manaxhimi Burimeve Njerëzore-Raste studimi, Ushtrime”, 2009
Plani i dizajnuar i mësimin	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e I-rë:</i>	Prezantimi i syllabusit / Natyra dhe zhvillimi i menaxhimit të burimeve njerëzore / Roli i menaxhimit të resurseve humane
<i>Java e II-të:</i>	Mjedisi për menaxhimin e resurseve humane / Analiza e punës të burimeve njerëzore
<i>Java e III-të:</i>	Planifikimi i nevojave për burime njerëzore
<i>Java e IV-të:</i>	Rekrutimi i burimeve njerëzore
<i>Java e V-të:</i>	Përzgjedhja e burimeve njerëzore
<i>Java e VI-të:</i>	Strategjia e burimeve njerëzore
<i>Java e VII-të:</i>	Testi i parë
<i>Java e VIII-të:</i>	Organizimi i punës / Planifikimi i programit trajnues
<i>Java e IX-të:</i>	Vlerësimi i performancës dhe metodat e vlerësimit të performancës
<i>Java e X-të:</i>	Motivimi
<i>Java e XI-të:</i>	Menaxhimi i shpërblimit
<i>Java e XII-të:</i>	Stresi dhe menaxhimi i stresit
<i>Java e XIII-të:</i>	Marrëdhëniet e punës / Kontratat kolektive
<i>Java e XIV-të:</i>	Shëndeti dhe siguria në punë
<i>Java e XV-të:</i>	Testi i dytë
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërate të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t’u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrihen vlerësimeve gjatë semestrit. Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet të respektojë orarinë ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjërata. Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studentin duhet t’i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.</p>	